



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ANGAZHIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE,
DHE ALEANCËS GAVI, PËR PJESËMARRJEN NË STRUKTURËN GLOBALE
TË QASJES NË VAKSINAT COVID-19 (COVAX FACILITY)”**

➤ **HYRJE**

Më 23 tetor 2020 Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19”

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm Z. Albert Nikolla, Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Znj. Gelardina Prodani, Sekretare e Përgjithshme e kësaj Ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Propozimin i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (Covax Facility)”, sipas relacionit që i bashkëlidhet tekstit, vjen si nismë ligjore, në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, e 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shqyrtim e miratim, me procedurë të përshpejtuar, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës.

Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility), e cila është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.734, datë 16.9.2020, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY).

Objekti i saj është blerja e vaksinës kundër COVID-19.

III. EFEKTET FINANCIARE

Ky projektligj shoqërohet me efekte financiare. Sipas marrëveshjes, detyrimi financiar konsiston në:

- Pika 2.1 ku parashikohet se “Pjesëmarrësi” (Republika e Shqipërisë”, në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, merr përsipër t’i paguajë GAVI-it shumën paraprake (*Upfront Payment*) para ose në afatet e pagesës së pjesëmarrësit, e cila, sipas pikës 1, b, paragrafi i 24-të, është në vlerën 3 534 000 (tre milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë) USD.
- Pika 1, b, paragrafi i 17-të, shuma e garancisë së ndarjes së rrezikut (*Risk Sharing Guarantee Amount*) në vlerën 456 000 USD (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë dollarë amerikanë).

Shuma totale është 3 990 000 (tre milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) dollarë amerikanë. Kjo shumë do të paguhet nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

IV. DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, pas miratimit të kalendarit dhe proces-verbaleve, ia dha fjalën përfaqësuesve nga Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zëvendësministri Nikolla dhe znj. Prodani shpjeguan se miratimi i këtij projektligji, që nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave të vitit 2020, lind për shkak të urgjencës që paraqet prokurimi i vaksinës kundër COVID-19. Më tej ata bënë një prezantim të nismës ligjore duke shpjeguar detajet teknike. Ata theksuan se marrëveshja në fjalë është firmosur nga rreth 90 shtete midis të cilëve Franca, Gjermania, Britania e Madhe etj.

Znj. Elona Gjebrea, në cilësinë e relatores, vlerësoi nismën duke e cilësuar atë si një kontribut shumë të rëndësishëm veçanërisht në kushtet aktuale. Më pas ajo u ndal në disa aspekte specifike të marrëveshjes dhe duke falënderuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për punën e lëvdueshme ftoi Komisionin ta miratonin projektligjin unanimisht.

Z. Ralf Gjoni shprehu skepticizmin e tij ndaj nismës duke e cilësuar atë si të papërshtatshme në kushtet e spekulimeve që po vazhdojnë të bëhen rreth COVID-19 dhe efikasitetit të vaksinave të ndryshme kundër tij.

Z. Adnor Shameti dhe z. Zef Shtjefni mbështetën plotësisht marrëveshjen dhe projektligjin dhe kërkuan të kalohej pa vonesë në votimin e tij.

Znj. Mimi Kodheli, shprehu mbështetjen e saj të plotë ndaj projektligjit dhe duke kujtuar faktin se ftesa për tu bërë pjesë e marrëveshjes vjen nga BE, ftoi Komisionin për të votuar projektligjin.

➤ **PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nën për nën dhe në tërësi dhe me shumicën e votave (një abstenim), e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE

Elona GJEBREA

KRYETARE

Mimi KODHELI

